

Hanife Leku

MONOPOLET DHE POZITAT DOMINUESE NË TREG SIPAS LEGJISLACIONIT TË KOSOVËS DHE SHQIPËRISË

Abstrakti

Monopoli është një struktur tregu në të cilin një furnizues i vetëm prodhon dhe shet produkte. Nëse ka një shitës të vetëm në një industri të caktuar dhe nuk ka zëvendësues të afërt për mallrat që prodhohen, atëherë në strukturën e tregut thuhet se është një monopol “i pastër”, Monopolet kanë ekzistuar gjatë gjithë historisë njerëzore. Kjo ndodh për shkak se ekzistojnë forcat e fuqishme si për krijimin ashtu edhe për mirëmbajtjen e monopolit. Në rrënjë të këtyre forcave është dëshira e njeriut për pasuri dhe pushtet së bashku me faktin se monopolet mund të jenë jashtëzakonisht profitabile dhe të ofrojnë pronarëve të tyre fuqi të jashtëzakonshme financiare, politike dhe sociale. Monopolet mund të lindin në disa rrethana; si rezultat i praktikave të biznesit normal që janë karakteristike e firmave në një industri shumë konkurruese. Pozita dominuese e ndërmarrjeve në treg, vetvetiu nuk është e ndaluar. Ndërmarrjet dominuese kanë fuqinë e tregut e cila iu mundëson të jenë të pavaruara nga konkurrentët dhe konsumatorët. Shkelja e konkurrencës ndodhë kur këto ndërmarrje e shfrytëzojnë për shtyrjen e konkurrentëve ose pengimin e hyrjes së të rinjve në treg përmes çmimeve të ulëta dhe joreale; pastaj edhe duke kufizuar qasjen e furnizuesve ose të blerësve, duke imponuar kushte të padrejta dhe të pabarabarta për bizneset ose çmime shumë të larta për konsumatorët.

Fjalët kyçe: Pozita dominuese, ndërmarrjet, konkurrenca, çmimet e blerësve, bizneset.